



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE

Nr. 47/3 Prot.

Tiranë më 17.11.2022

V E N D I M

Nr. 121/1, datë, 17. 11. 2022

PËR DHËNIE MASE DISIPLINORE

Komisioni i Policisë Gjyqësore pasi shqyrtoi në seancë dëgjimore materialet e procedimit disiplinor në ngarkim oficerit të policisë gjyqësore Armanda Shahini, dëgjoi pretendimet e saj dhe pasi analizoi çështjen në tërësi,

K O N S T A T O I:

1. Me kërkesë të Prokurorit të Përgjithshëm, nr.892/9 ex 21 datë 23.09.2022, “Për procedimin disiplinor të oficerit të Policisë Gjyqësore të Seksionit të Policisë Gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, Armanda Shahini”, protokolluar në Komisionin e Policisë Gjyqësore, me numer protokollit 47, datë 23.09.2022, Komisioni i Policisë Gjyqësore, në përmbushje të detyrimeve ligjore të përcaktuara në nenin 36, pika 1 e ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, ka nxjerrë Urdhërin nr.121, datë 07.10.2022 “Për fillimin e procedimit disiplinor ndaj oficerit të policisë gjyqësore të Seksionit të Policisë Gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, Armanda Shahini, për kryerjen e shkeljeve disiplinore në formën :

“veprimet dhe mosveprimet e oficerëve të Policisë Gjyqësore, të cilat passjellin zvarritje të proçeseve hetimore”,

parashikuar si shkelje disiplinore nga ligji nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, neni 33, pika 2, gërma “a” e këtij ligji.

2. Nga përmbajtja e kërkesës së Prokurorit të Përgjithshëm dhe Relacioni shoqërues, rezulton se si bazë për kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor kanë shërbyer veprimet dhe mosveprimet, në shkelje të kërkesave të Kodit të Proçedurës Penale dhe ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, nga ana e oficerit të Policisë Gjyqësore

të Seksionit të Policisë Gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, Armanda Shahini , gjatë hetimit të **23** procedimeve penale.

Nga aktet që u administruan gjatë seances dëgjimore per procedimin disiplinor, u provua se:

2.1 Prokuroria e Përgjithshme, mbi bazën e Urdhërit Nr.61 datë 02.06.2021, të Prokurorit të Përgjithshëm, ka ushtruar kontroll mbi treguesi e punës së oficerëve të Policisë Gjyqësore, të Seksionit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan për vitin 2021.

Objekti i kontrollit ishte ligjshmëria e veprimeve hetimore të oficerëve të Policisë Gjyqësore në;

- Procedimet penale të regjistruara nga data 01.05.2020 – 31.05.2021, dhe ato të mbartura nga vitit 2019, për të cilat është vendosur pushimi i procedimit penal, janë dërguar për gjykim, apo nuk kanë përfunduar hetimet dhe janë mbartur për vitin 2021.

- Mosfillimet e procedimeve penale të vendosura për materialet kallëzuese/referuese të regjistruara prej datës 01.05.2020 – 31.05.2021.

- Disiplina në punë.

Nga ana e grupit të punës në përfundim të procesit të kontrollit të ushtruar për cdo oficer të policisë gjyqësore, është përpiluar raporti përfundimtar përmbledhës në të cilan janë pasqyruar problematikat si në nivel organizativ të punës së seksionit të policisë gjyqësore, pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan ashtu dhe në nivel individual për secilin oficer të policisë gjyqësore.

Në përfundim të kontrollit të ushtruar për periudhën objekt inspektimi u konstatua se ne hetimin e procedimeve penale të hetuara nga oficeri i Policisë Gjyqësore Armanda Shahini u konstatua se në disa procedime penale janë lejuar zvarritje në hetim dhe nuk janë respektuar afatet e caktuara në urdhërin e delegimit të prokurorit për kryerjen e veprimeve hetimore.

Zvarritjet e veprimeve hetimore janë të pajustificuara dhe në shkelje të dispozitave ligjore të Kodit të Procedurës Penale dhe ligjit 25/2019, “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, të cilat rregullojnë dhe disiplinojnë hetimin dhe afatet e tij.

2.2. Në datën 31.01.2020 është regjistruar **procedimi penal nr. 54**, për veprën penale “Vjedhja”, parashikuar nga neni 134 I Kodit Penal.

Gjatë hetimit të këtij procedimi penal, konstatohen zvarritje të pajustificuara ne kryerjen e veprimeve hetimore. Procedimi penal eshte mbajtur ne dore në mënyrë të pajustificuar dhe pa kryer veprime hetimore, nga ana e oficerit të policisë gjyqësore Armanda Shahini për 5 muaj, nga data 13.01.2020 deri ne date 12.06.2020.

Prokurori i çështjes , në datën 13.01.2020, ka nxjerë urdhër për kryerje të veprimeve hetimore, duke caktuar oficeren e policisë gjyqësore Armanda Shahini për kryerjen e tyre. Nga aktet e dosjes ka rezultuar se për 5 muaj, nga data e urdhëtit të prokurorit deri në datën 03.06.2020, nuk është

kryer asnjë veprim hetimor. Rezulton se Oficerja e Policisë Gjyqësore Armanda Shahini ka nisur veprimet hetimore më datën 12.06.2020, pra pas 5 muajve nga data e urdhërit të Prokurorit. Në këto rrethana, oficeri i Policisë Gjyqësore Armanda Shahini, nuk ka respektuar afatin e caktuar nga prokurori për kryerjen e veprimeve hetimore dhe pa shkaqe të arsyeshme, ka zvarritur hetimet duke mbajtur dosjen pa veprime për 5 muaj.

2.3. Në datën 09.10.2019 është regjistruar **proçedimi penal nr. 2029** për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a I Kodit Penal.

Konstatohen zvarritje të pajustificuara ne hetimin e çështjes dhe mbajtja e dosje në dorë pa kryer veprime për një kohë të gjatë dhe në mënyrë të pajustificuar. Për një vit nuk është kryer asnjë veprim i mirëfillt hetimor nga ana e oficerit të policisë gjyqësore Armanda Shahini. Gjatë kësaj periudhe, vetëm është admininstruar pas një viti akti i ekspertimit dhe nuk ka patur veprime te tjera. Oficeri i policisë gjyqësore dhe prokurori duhet te ishin treguar aktiv ne admnistrimin e ketij akti, pasi ka kaluar cdo afat i percaktuar nga ligji për detyrimin që ka eksperti per te dorezuar aktin.

Për sa sipër, oficeri i Policisë Gjyqësore Laureta Fusha, pa shkaqe të arsyeshme, ka zvarritur hetimet duke mbajtur dosjen pa veprime për 1 vit e 2 muaj.

2.4. Në datën 21.10.2019 është regjistruar **proçedimi penal nr. 2106** për veprën penale “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulsive telefonike”, parashikuar nga neni 137/1 I Kodit Penal.

Konstatohen zvarritje të pajustificuara ne hetimin e çështjes dhe mbajtja e dosjes në dorë pa kryer veprime, në mënyrë të pajustificuar. Rezulton se nga ana e oficerit të policies gjyqësore Armanda Shahini për më tepër se 8 muaj, nga muaji tetor i vitit 2019 deri ne muajin korrik 2020, nuk është kryer asnjë veprim hetimor.

Sikurse rezulton nga aktet, veprimet hetimore nga ana e oficeres së Policisë Gjyqësore Armanda Shahini, janë kryer jashtë afatit të caktuar nga prokurori dhe proçedimi penal është mbajtur në dorë pa shkaqe të justifikuara për 8 muaj.

2.5. Në datën 13.09.2018 është regjistruar **proçedimi penal nr. 1644**, për veprën penale “Prerja e paligjshme e pyjeve”, parashikuar nga neni 215 i Kodit Penal, pushuar 10.09.2020

Konstatohen zvarritje të pajustificuara ne hetimin e çështjes, mbajtja e dosje në dorë pa kryer veprime në mënyrë të pajustificuar dhe kryerja e veprimeve hetimore jashtë afatit të caktuar nga prokurori

Për këtë procedim penal nr. Prokurori i çështjes ka nxjerë urdhër për kryerjen e veprimeve me datë 17.09.2018 duke caktuar oficerin e policisë gjyqësore Armanda Shahini për kryerjen e hetimeve dhe ka caktuar afat për kryerjen e veprimeve hetimore datën 20.10.2018.

Rezulton se që nga data e nxjerrjes së urdhërit të delegimit, 17.09.2018 deri më datë 20.10.2018, nuk është kryer asnjë veprim hetimor nga oficeri i Policisë Gjyqësore Armanda Shahini. Veprimet hetimore kanë filluar të kryen në datën 26.10.2018, tej cdo afati të parashikuar në urdhërin e prokurorit,

Si konkluzion, veprimet hetimore nga ana e oficeres së Policisë Gjyqësore Armanda Shahini, janë kryer jashtë afatit të caktuar nga prokurori dhe proçedimi penal është mbajtur në dorë pa

shkaqe të justifikuara për gati 2 vjet. Nuk mund të justifikohet për çfardo lloj arsyeje mbajtja në hetim e një procedimi penal qëbënë fjal për një kundravajtje penale.

2.6 Në datën 25.07.2019 është regjistruar **procedimi penal nr. 1453** për veprën penale “Mashtrimi”, parashikuar nga neni 143 I Kodit Penal.

Konstatohen zvarritje të pajustificuara ne hetimin e çështjes, mbajtja e dosjes në dorë pa kryer veprime, në mënyrë të pajustificuar dhe kryerja e veprimeve hetimore jashtë afatit të caktuar nga prokurori

Për këtë procedim penal nr.Prokurori i çështjes ka nxjerë urdhër për kryerjen e veprimeve me datë 06.09.2019 duke caktuar oficerin e policisë gjyqësore Armanda Shahini për kryerjen e hetimeve dhe ka caktuar afat për kryerjen e veprimeve hetimore muajin shtator 2019.

Rezulton se që nga data e nxjerrjes së urdhërit të delegimit, 17.09.2018 deri në muajin shkurt 2020, nuk është kryer asnjë veprim hetimor nga oficeri i Policisë Gjyqësore Armanda Shahini . Veprimet hetimore kanë filluar të kryen në muajin shkurt 2020, tej cdo afati të parashikuar në urdhërin e prokurorit,

Sikurse rezulton nga aktet, veprimet hetimore për këtë procedim penal kane nisur me vonese dhe veprimet e para hetimore jane kryer pas 5 muaj nga urdhëri e delegimit të prokurorit, ku janë caktuar dhe afatet për kryerjen e veprimeve hetimore. Perfundimi i hetimeve eshte bere pas nje viti, dhe gjatë kësaj periudhe një vjeçare jane administruar vetem disa shkresa dhe janë pyetur vetem dy persona, veprime të cilat janë kryer ne muajin shkurt 2020.

Për sa sipër, veprimet hetimore nga ana e oficeres së Policisë Gjyqësore Armanda Shahini, janë kryer jashtë afatit të caktuar nga prokurori dhe procedimi penal është mbajtur në dorë pa shkaqe të justifikuara për 1 vit.

2.7 Në datën 28.03.2019 është regjistruar **procedimi penal nr. 610** , për veprën penale “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulsive telefonike”, parashikuar nga neni 137/1 I Kodit Penal, kërkesa për pushim 28.02.2021.

Konstatohen zvarritje të pajustificuara ne hetimin e çështjes dhe mbajtja e dosjes në dorë pa kryer veprime për një kohë të gjatë dhe në mënyrë të pajustificuar si dhe kryerje e veprimeve hetimore jashtë afatit të caktuar nga prokurori.

Pavarësisht pretendimeve të oficeres së policisë gjyqësore Armanda Shahini, rezulton qe procedimi penal është mbajtur në dorë për një vit pa u kryer asnjë veprim i mirfilltë hetimor. Sipas vetë shpjegimeve të oficeres së policisë gjyqësore Armanda Shahini, për periudhen 28.03.2019 deri në datën 20.07.2020, janë kryer shumë pak veprime hetimore., është bërë një shkres OSSHE në datën 06.05.2019 dhe janë pyetur disa persona.

Si konkluzion, veprimet hetimore nga ana e oficeres së Policisë Gjyqësore Armanda Shahini , janë kryer jashtë çdo afati të arsyeshëm, dhe procedimi penal është mbajtur në dorë pa shkaqe të justifikuara për 1 vit .

2.8 Në datën 12.11.2018 është regjistruar **proçedimi penal nr. 2084** për veprën penale “Vjedhja”, parashikuar nga neni 134 I Kodit Penal, kërkesa për pushim 15.06.2020.

Konstatohen zvarritje të pajustificuara ne hetimin e çështjes dhe mbajtja e dosjes në dorë pa kryer veprime për një kohë të gjatë dhe në mënyrë të pajustificuar.

Rezulton se pasi kanë përfunduar veprimet hetimore, dosja është mbajtur në dorë pa u kryer asnjë veprim hetimor dhe pa shkaqe të arsyeshme për 1 vit. Mandej nga oficeri i policisë gjyqësore Armanda Shahini është përpiluar relacioni përfundimtar për mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

2.9 Në datën 16.04.2019 është regjistruar **proçedimi penal nr. 774**, për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, kërkesa për gjykim 03.07.2020.

Konstatohen zvarritje të pajustificuara ne hetimin e çështjes dhe mbajtja e dosjes në dorë pa kryer veprime për një kohë të gjatë dhe në mënyrë të pajustificuar. Megjithëse veprimet hetimore për këtë proçedim penal nuk kanë qenë të shumta dhe voluminoze, procedimi penal është mbajtur në hetim pa arsye për një kohë të gjatë.

2.10 Në datën 10.04.2019 është regjistruar **proçedimi penal nr. 711**, për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a I Kodit Penal, kërkesa për gjykim 12.04.2021.

Konstatohen zvarritje të pajustificuara ne hetimin e çështjes dhe mbajtja e dosjes në dorë pa kryer veprime për një kohë të gjatë dhe në mënyrë të pajustificuar. Megjithëse veprimet hetimore për këtë proçedim penal nuk kanë qenë të shumta dhe voluminoze, procedimi penal është mbajtur në hetim pa arsye për një kohë të gjatë.

Rezulton se proçedimi penal është mbajtur në dorë pa veprime hetimore për gati 9 muaj, nga data 10.04.2019 deri në datën 28.01.2020, kur është kryer veprimi i pare hetimore.

2.11 Në datën 25.03.2019 është regjistruar **proçedimi penal nr. 584**, për veprën penale “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulsive telefonike”, parashikuar nga neni 137/1 I Kodit Penal, kërkesa për pushim date 16.06.2021.

Konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit, të cilat konsistojnë në mosvijueshmërinë e kryerjes se veprimeve hetimore. Për afro nje vit nga momenti i regjistrimit të procedimit penal nuk është kryer asnjë veprim hetimor, nga data 25.03.2019 deri në datën 02.03.2020”. Proçedimi penal është mbajtur në hetim pa shkaqe të arsyeshme nga prokurori dhe oficeri I policisë gjyqësore Armanda Shahini, për afro 2 vjet e 3 muaj. Pavaresisht pretendimeve të oficeres së policisë gjyqësore Armanda Shahini, mbajtja e dosjes jashtë çdo afati të arsyeshëm është e pajustificuar. Edhe për periudhën që ajo pretendon se ka disponuar me veprime hetimore, numri i veprimeve të kryera nuk justifikon mbajtjen e dosjes për një periudhe te gjate dhe vonesat ne hetim.

2.12 Në datën 28.03.2019 është regjistruar **proçedimi penal nr. 606**, për veprën penale “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulsive telefonike”, parashikuar nga neni 137/1 I Kodit Penal, pushuar 26.04.2021.

Konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit që konsistojnë në mosvijueshmërinë e kryerjes se veprimeve hetimore. Dosja është mbajtur në dorë pa kryer veprime për një kohë të gjatë dhe në mënyrë të pajustificuar. Megjithëse veprimet hetimore për këtë procedim penal nuk kanë qenë të shumta dhe voluminoze, procedimi penal është mbajtur në hetim pa arsye për 11 muaj.

2.13 Në datën 10.04.2019 është regjistruar **procedimi penal nr.712**, për veprën penale “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulsive telefonike”, parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal, pushuar 16.06.2021.

Konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit që konsistojnë në mosvijueshmërinë e kryerjes se veprimeve hetimore. Për afro një vit e dy muaj nga momenti i regjistrimit të këtij procedimi penal është përpiluar vetëm një shkresë, në datë 06.05.2019 dhe nuk është kryer asnjë veprim tjetër, hetimor. Nga data 10.04.2019 deri në datën 12.06.2020 nuk është kryer asnjë veprim hetimor. Procedimi penal është mbajtur në hetim nga prokurori dhe oficeri i policisë gjyqësore, pa shkaqe të arsyeshme për afro 2 vjet e 2 muaj.

2.14 Në datën 12.09.2019 është regjistruar **procedimi penal nr. 1782**, për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, dërguar gjykim dt. 28.09.2020.

Konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit që konsistojnë në vijueshmërinë e kryerjes se veprimeve hetimore. Dosja është mbajtur në dorë pa kryer veprime për një kohë të gjatë dhe në mënyrë të pajustificuar. Megjithëse veprimet hetimore për këtë procedim penal nuk kanë qenë të shumta dhe voluminoze, procedimi penal është mbajtur në hetim pa arsye për një vit. Rezulton se procedimi penal është mbajtur në dorë pa veprime hetimore për gati 5 muaj, nga data 12.09.2019 deri në datën 31.01.2020, kur është kryer veprimi i pare hetimore.

2.15 Në datën 25.07.2019 është regjistruar **procedimi penal nr. 1447**, për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal dërguar gjykim dt. 29.06.2020.

Konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit që konsistojnë në mosvijueshmërinë e kryerjes se veprimeve hetimore. Dosja është mbajtur në dorë pa kryer veprime për një kohë të gjatë dhe në mënyrë të pajustificuar. Megjithëse veprimet hetimore për këtë procedim penal nuk kanë qenë të shumta dhe voluminoze, procedimi penal është mbajtur në hetim pa arsye për 11 muaj.

Rezulton se procedimi penal është mbajtur në dorë pa veprime hetimore për gati 6 muaj, nga data 25.07.2019 deri në datën 13.02.2020. kur është kryer veprimi i pare hetimore.

2.16 Në datën 11.09.2019 është regjistruar **procedimi penal nr.1758**, për veprën penale “Shkelje rregullave të mbrojtjes në punë”, parashikuar nga neni 289 i Kodit Penal pushuar 10.07.2020.

Konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit që konsistojnë në mosvijueshmërinë e kryerjes se veprimeve hetimore dhe moskryerje e veprimeve hetimore brenda afatit të caktuar nga prokurori.

Rezulton se fillimisht hetimet për këtë proçedim disiplinor janë kryer nga oficeri I policisë gjyqësore të Komisarariatit të Policisë Elbasan. Në datën 10.01.2020, procedimi penal u ka kaluar për ndjekje oficerëve të policisë gjyqësore Armanda Shahini dhe Shkëlzen Xhameta.

Për këtë procedim penal Prokurori i çështjes ka nxjerë urdhër për kryerjen e veprimeve me datë 10.01.2020 duke ngarkuar këta dy oficerë të policisë gjyqësore për kryerjen e hetimeve dhe ka caktuar afat për kryerjen e veprimeve hetimore datën 01.03.2020.

Rezulton se që nga data e nxjerrjes së urdhërit të delegimit, 10.01.2020 deri më datë 24.06.2020, nuk është kryer asnjë veprim hetimor nga oficeri i Policisë Gjyqësore Armanda Shahini . Veprimet hetimore kanë filluar të kryen në datën 24.06.2020, tej cdo afati të parashikuar në urdhërin e prokurorit,

2.17 Në datën 07.12.2018 është regjistruar **proçedimi penal nr. 2258**, për veprën penale “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulsive telefonike”, parashikuar nga neni 137/1 I Kodit Penal, dërguar gjykim dt. 04.08.2020.

Konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit që konsistojnë në mosvijueshmërinë e kryerjes se veprimeve hetimore. Dosja është mbajtur në dorë pa kryer veprime për një kohë të gjatë dhe në mënyrë të pajustificuar. Megjithëse veprimet hetimore për këtë proçedim penal nuk kanë qenë të shumta dhe voluminoze, procedimi penal është mbajtur në hetim pa arsye për 1 vit e 7 muaj.

2.18 Në datën 17.01.2019 është regjistruar **proçedimi penal nr. 117**, për veprën penale “Përdorimi me keqdashje i thirjeve telefonike”, parashikuar nga neni 275 i Kodit Penal, pushuar 03.11.2020.

Konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit që konsistojnë në mosvijueshmërinë e kryerjes se veprimeve hetimore. Proçedimi penal është mbajtur në hetim pa shkaqe të justifikuara dhe tej cdo afati të arsyeshëm, për afro 1 vit e 5 muaj.

2.19 Në datën 22.02.2019 është regjistruar **proçedimi penal nr. 384**, për veprën penale “Përdorimi me keqdashje i thirjeve telefonike”, parashikuar nga neni 275 i Kodit Penal, pushuar 22.06.2020 .

Konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit që konsistojnë në mosvijueshmërinë e kryerjes se veprimeve hetimore. Proçedimi penal është mbajtur në hetim pa shkaqe ligjore dhe tej cdo afati të arsyeshëm për afro 1 vit e 4 muaj.

2.20 Në datën 21.11.2019 është regjistruar **proçedimi penal nr. 2317**, për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a I Kodit Penal, dërguar gjykim dt. 16.07.2020.

Konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit që konsistojnë në mosvijueshmërinë e kryerjes se veprimeve hetimore. Rezulton se proçedimi penal është mbajtur në hetim pa shkaqe ligjore për afro 8 muaj.

2.21 Lidhur me 4 proçedimet penale **nr. 643**, datë 01.04.2019, **nr. 1052**, datë 29.05.2019, **nr. 722**, datë 12.04.2019 dhe **nr. 1930**, datë 24.09.2019, të cilat përfshihen në propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm, në grupin e proçedimeve penale për të cilat kërkohet proçedimi disiplinor, Komisioni nuk konstaton zvarritje në hetimin e këtyre proçedimeve penale, nga ana e oficerit të Policisë Gjyqësore Armanda Shahini.

Komisioni i Policisë Gjyqësore, pas administrimit të provave të paraqitura nga oficeri i Policisë Gjyqësore Armanda Shahini, arriti në përfundimin se në proçedimet penal të sipërcituara, nuk evidentohen veprime apo moveprime të saj, që pasjellin zvarritje në hetimin e këtyre proçedimeve penale. Proçedimet penale janë mbajtur për një kohë gjatë pa veprime nga prokuroret e ceshtjeve.

3. Nga tërësia e materialeve të administruara gjatë shqyrtimit të proçedimit disiplinor, analiza e tyre dhe shpjegimet e vetë subjektit të proçedimit disiplinor, provohet se gjatë hetimit të 19 proçedimeve penale, të trajtuara më lartë, nga ana e oficerit të policisë gjyqësore Armanda Shahini, janë shkëlur kërkesat e Kodit të Proçedurës Penale, që disjellojnë afatet e hetimit dhe dispozitat e Ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore që rregullojnë mardhëniet midis oficerit të Policisë Gjyqësore dhe Prokurorit. Sikurse rezulton nga aktet e dosjeve penale të sipërcituara, shumë veprime hetimore janë kryer tej afatit të caktuar në urdherin e delegimit të prokurorit dhe tej afatit 3 mujor që parashikon neni 323 i K.K.Pr.Penale. Neni 323 i K.Pr.Penale parshikon se afati i përfundimit të hetimeve është tre muaj nga data në të cilin emri i personit që i atribuohet vepra penale është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale.”

Ndërsa në nenin 7, pika 2 të ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore, është parashikuar detyrimi që ka oficeri i Policisë Gjyqësore për të zbatuar urdhërat dhe udhëzimet e prokurorit për përcaktimin e çështjeve që duhen hetuar me përparësi, veprimeve konkrete që duhen kryer, si dhe kohëzgjatjen e nevojshme të hetimeve. Sikurse u provua gjatë shqyrtimit të proçedimit disiplinor, në kundërshtim me këtë detyrim ligjor, për të gjitha proçedimet penale që utrajtuan më sipër, oficeri i Policisë Gjyqësore Armanda Shahini, nuk ka respektuar afatet e hetimit dhe afatet e caktuara nga prokurori për kryerjen e veprimeve hetimore dhe përfundimin e çështjes.

4. Në çmim të Komisionit, shkëljet e kërkesave të Kodit të Proçedurës Penale dhe ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, lidhur me afatin e hetimeve dhe moskryerja e veprimeve hetimore brenda afateve të parashikuara në ligj dhe urdherin e delegimit të prokurorit, nga oficeri i policisë gjyqësore Armanda Shahini, për vetë natyrën e tyre dhe pasojat që sjellin, përbëjnë shkëlje disiplinore, të parashikuar nga neni 33 i ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”

Komisioni vlerëson se shkëlja e kërkesave të Kodit të Proçedurës Penale, dhe neni 7 të ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, mbajtja në dorë e proçedimit penal, pa kryer veprime hetimore dhe kryerja e tyre jashtë afateve të caktuara nga prokurori, përbëjnë shkëlje disiplinore në formën, **“veprimet dhe mosveprimet e oficerëve të policisë gjyqësore, të cilat passjellin zvarritje të proçeseve hetimore”**, parashikuar nga neni

33, pika 2, gërma “a” e ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

Lidhur me këto shkelje, Oficeri i Policisë Gjyqësore, Armanda Shahini, nuk i pranon ato dhe shpjegon se vonesat dhe zvaritjet kanë ardhur për shkak se dosjet janë mbajtur nga prokuroret dhe se shkak është bërë dhe pandemia, kufizimi i veprimeve në këtë situatë.

Këto shpjegime dhe pretendime të oficerit të policisë gjyqësore Armanda Shahini, nuk justifikojnë shkeljet e kryera dhe vonesat e gjata në hetimin e procedimeve penale dhe zgjatjen e hetimeve tej çdo afati të arsyeshëm. Nuk mund të justifikohet me situatën e pandemisë mbajtja pa veprime e dosjeve penale për vepra penale të lehta, që kërkojnë një numër të vogël veprimesh hetimore, për periudhë të gjata kohe deri në dy vjet e gjysëm.

Referuar, ligjit nr.25/2019 “Për funksionimin dhe organizimin e Policisë Gjyqësore”, nenit 7, pika 2, oficerët e Policisë Gjyqësore, kanë detyrimin ligjor të zbatojnë urdhërat dhe udhëzimet e prokurorit për përcaktimin e çështjeve që duhen hetuar me përparësi, e veprimeve konkrete që duhen kryer, si dhe për kohëzgjatjen e nevojshme të hetimeve. Ndërsa në nenin 33, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale parashikohet detyrimi i Policisë Gjyqësore për të kryer detyrat që i janë caktuar nga prokurori dhe të njoftojë atë menjëherë mbi rezultatet e tyre. Për procedimet penale objekt i shqyrtimit të këtij procedimi disiplinor, prokurori ka caktuar veprimet hetimore që duhet të kryeshin dhe afatin brenda të cilit duhet të kryeshin nga oficeri i policisë gjyqësore, të cilat nuk janë respektuar nga oficeri i Policisë Gjyqësore Armanda Shahini.

Mosrespektimi afateve të caktuara nga prokurori, kryerja e veprimeve hetimore tej këtyre afateve, dhe mosnjoftimi i prokurorit, për rezultatet brenda afatit të caktuar prej tij, përbënë shkelje të dispozitave ligjore të sipërcituara dhe zvarritje në hetim, në kuptimin që Ligji 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore” jep për konceptin e zvarritjeve në hetim, të cilat sjellin si pasojë përgjegjësi disiplinore për oficerin e Policisë Gjyqësore.

Në thelb, afatet e hetimit të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale janë afate për prokurorin. Sipas parashikimeve të K.Pr.Penale, përgjegjës për hetimin e çështjes është prokurori. Ai ka përgjegjësinë për ecurinë e çështjes dhe përfundimin e saj në afatet që ka caktuar Kodi i Procedurës Penale.

Oficeri i Policisë Gjyqësore veç parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale, kryesisht lidhet me urdhërat e prokurorit për afatet e hetimit. Prokurori i cakton ato në bazë të një plani që ai ka për hetimin dhe përfundimin e çështjes. Për oficerin e Policisë Gjyqësore, afate të hetimit janë ato që cakton prokurori në urdhërat për kryerjen e veprimeve hetimore.

5. Duke e konsideruar të provuar shkeljen disiplinore të kryera nga oficeri i policisë gjyqësore Armanda Shahini, Komisioni, për caktimin e llojit të masës disiplinore ndaj tij, i referohet ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore.”

Ligji i sipërcituar, në nenin 33 i klasifikon shkeljet disiplinore të kryera nga oficerët e policisë gjyqësore në tre kategori:

- a) Të lehta;
- b) Të rënda;

c) Shumë të rënda.

Po ky ligj, në gërmën “a”, pika 2, e nenit 33, parashikon si shkelje të lehtë, “*veprimet dhe mosveprimet e oficerëve të Policisë Gjyqësore, të cilat passjellin zvarritje te proceseve hetimore*”.

Për caktimin e masës disiplinore ndaj oficerit të Policisë Gjyqësore, Armanda Shahini, Komisioni merr në konsideratë llojin dhe natyrën e shkeljes disiplinore të kryera prej saj, pasojat që ato kanë sjellë, rrethanat e dala gjatë shqyrtimit.

Gjithashtu Komisioni i referohet dispozitave të ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore” për parashikimet që ai bën për masat disiplinore, në raport me shkeljen e kryer.

Ligji i sipërcituar, në nenin 34 në pikën 1, parashikon llojet e masave disiplinore duke i klasifikuar sipas radhës, a) vërejtje me shkrim, b) vërejtje me paralajmërim, c) ulje në detyrë me afat nga tre muaj deri në në vit, ç) pezullim nga detyra deri në 6 muaj dhe d) largim nga detyra ose çdo masë tjetër e barasvlefshme me të.

Në pikën 2 të nenit 34 parashikohet që, për shkeljet e lehta jepen masat disiplinore “vërejtje me shkrim” ose “vërejtje me paralajmërim”.

Referuar dispozitave ligjore të sipërpërmendura dhe shkeljeve konkrete të kryera, Komisioni çmon që ndaj oficerit të Policisë Gjyqësore Armanda Shahini të japë masën disiplinore “**vërejtje me shkrim**”, parashikuar nga neni 34, pika 1, gërma “a” e ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”.

Për sa më sipër, në bazë të neneve 10, shkronja “ç”,11, pika 4, nenit 33, pika 2, gërmat “a”, dhe “c”, neni 34, pika 1, gërma “b”, dhe neni 38 të Ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, Komisioni i Policisë Gjyqësore me katër vota pro.

V E N D O S I:

1. Oficerit të policisë gjyqësore Armanda Shahini, me detyrë oficer i policisë gjyqësore në Seksionin e Policisë Gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, i jepet masa disiplinore “**Vërejtje me shkrim**”.
2. Me këtë vendim , të njihet oficeri i policisë gjyqësore Armanda Shahini, i cili, në bazë të nenit 39 të ligjit 25/2019, “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore, ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative.
3. Kopje të këtij vendimi i dërgohen Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.
4. Vendimi të administrohet në dosjen personale të oficerit të policisë gjyqësore Armanda Shahini.

KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE

KRYETARI

ALFRED PROGONATI



ANËTAR

ARJAN MUÇA

munjon

ANËTAR

HARI GOGO

Hago

ANËTAR

REDI VASILI

ANËTAR

ALBERT MUÇO

Albert Muço